


ME MENDIM KRITIK DERI TE DEMASKIMI I DEZINFORMATAVE



DORACAK PËR ARSIM JOFORMAL PËR NJOHURITË ELEMENTARE MEDIATIKE



Botues:

Fondacioni për internet dhe shoqëri Metamorfozis
EUROTHINK - Qendra për Strategji Evropiane

Për botuesit:

Bardhyl Jashari Drejtor ekzekutiv Metamorfozis
Ljupço Petkovski, Drejtor ekzekutiv. EUROTHINK

Autorë:

Biljana Goneska
Vasko Magleshev
Tanja Andonova Mitrevska
Vladimir Petreski

Redaktorë:

Filip Stojanovski
Goran Llazarov
Violeta Gligoroska

Redaktimi grafik:

Dragan Dodevski

Lektura:

Eleonora Stojkovska Popetreska

Përkthimi në shqip:

Rexhep Xheladini, Valon Abdiu

CIP - Katalogizacija во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

37:316.774(035)

ME mendim kritik deri te demaskimi i dezinformatave [Електронски извор] : doracak për arsim
joformal për njohuritë elementare mediatike / [autorë Biljana Goneska ... и др.]. - Скопје :
Metamorfozis : Qendra për strategji Evropiane Eurothink, 2019

Начин на пристап (URL): <https://www.metamorphosis.org.mk>. - Текст во PDF Формат, содржи 109
стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 28.11.2019. - Други автори:
Vasko Magleshev, Tanja Andonova Mitrevska, Vladimir Petreski. - Библиографија: стр. 107-109. -
Содржи и: Shtojcë

ISBN 978-608-263-023-6 (Метармофозис)

ISBN 978-608-66235-6-2 (Евротинк)


1. Goneska, Biljana [автор] 2. Magleshev, Vasko [автор] 3. Andonova Mitrevska, Tanja [автор]
4. Petreski, Vladimir [автор]

а) Медиумска писменост - Прирачници

COBISS.MK-ID 111739146

Ky doracak është përgatitur në kuadër të projektit "Mendim kritik për qytetarë me shkathtësi mediatike - KritThink, i implementuar nga Fondacioni për Internet dhe Shoqëri – Metamorfozis dhe EUROTHINK "- Qendra për Strategji Evropiane, dhe i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Për përgatitjen e Doracakut mjete financiare u siguruan edhe nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Fondacionit për Internet dhe Shoqëri Metamorfozis dhe e EUROTHINK - Qendra për Strategji Evropiane dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe të Qeverisë Britanike.



Përmbajtjet e këtij botimi janë publikuar nën licencën "Creative Commons: Thekso burimin" <https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/>- lejohet shpërndarja, kopjimi dhe rishpërndarja, si dhe përshtatja e tyre me kushtin e vetëm që të theksohet se burimi është projektit KriThink i mbështetur nga Bashkimit Evropian dhe i zbatuar nga Metamorfozis dhe EUROTHINK.

Përmbajtja:

Për doracakun	6
Parathënie	7
Hyrje	8
Thelbi i gazetarisë	9
Të menduarit kritik	13
Standardet e të menduarit kritik	13
Pse të menduarit kritik është i rëndësishëm për njohuritë elementare mediatike?	15
Mekanizmat psikologjikë për të menduarit jokritik	15
Mediat	21
Roli dhe funksionet e mediave në shoqëri	22
Media në realitetin shoqëror	23
Media dhe politika	23
Institucionet rregullatorë dhe vetë-rregullatorë të mediave	23
Si mediat e prezantojnë dhe krijojnë realitetin	25
Shembuj të titujve dhe lajmeve të konstruktuar	26
Mediat në hapësirën digjitale	28
Njohuritë elementare mediatike	29
Çfarë janë njohuritë elementare mediatike?	29
Politika arsimore dhe njohuritë elementare mediatike	29
Njohuritë elementare digjitale	30
Liria e fjalës kundrejt gjuhës së urrejtjes	36
Dezinformim, propagandë dhe spinim	44
Çka është lajmi i rremë?	44
Shembuj historikë të lajmeve të rreme dhe propagandës në të kaluarën	46
Lajmet e rreme në botë - problem global për demokracinë	46
Maqedonia e Veriut - vend me "ndjeshmërinë" më të lartë për lajme të rreme në Evropë	47
Llojet e përmbajtjes dhe shembujt e lajmeve të rreme në kaosin e informacionit	48
Velesi dhe roli i tij në zgjedhjet presidenciale në SHBA	54
Mekanizmat për përhapjen e lajmeve të rreme	55
Verifikimi i fakteve (fact checking)	58

Verifikim i kryqëzuar (cross-checking)	61
Mospërputhjet logjike më të zakonshme dhe paragjykimet kognitive në manipulimin e lajmeve	61
Si të zbulohen lajmet e rreme në mediat digjitale?	64
Zbatimi i Metodologjisë së Shërbimit për Verifikimin e Fakteve në Media	66
Përmbledhje e aktiviteteve	73
Aktiviteti 1: Njohja e formave gazetareske	73
Aktiviteti 2: Unë gazetar	81
Aktiviteti 3: Fakt/Mendim	82
Aktiviteti 4: Mungesa e vëmendjes	84
Aktiviteti 5: Ndërhyrësi në tekst	86
Aktiviteti 6: Argumente të forta dhe të dobëta	89
Aktiviteti 7: Leximi i artikujve në media	91
Aktiviteti 8: A e zbulon titulli temën e tekstit?!	95
Aktiviteti 9: Lajme false dhe propaganduese	98
Aktiviteti 10: Verifikimi i publikimeve gazetareske	100
Bibliografia	107

Për doracakun...

Shoqëri e fortë demokratike, në mes tjerash nënkupton që qytetarët të kenë qasje tek informatat e sakta dhe në kohë. Gjithashtu në mënyrë plotësuese ata duhet të kenë shkathtësi, për informatat që i marrin nga burime të ndryshme – të cilat jo gjithmonë janë të sakta dhe me qëllim të mirë – ti analizojnë, ti vendosin në kontekstin e duhur, si dhe ti ndërlidhin me informatat tjera, të mendojnë në mënyrë kritike dhe të jenë në gjendje ta vlerësojnë kualitetin e tyre dhe si rezultat i kësaj të marrin vendime dhe gjykime të bazuara në fakte.

Në kohën e tashme kur kemi numër të konsiderueshëm të burimeve me dezinformata si dhe manipulime të fabrikuara me qëllim të keq, të cilat e kontaminojnë diskursin publik dhe i vënë njerëzit në hamendje, bëhet rëndë edhe për institucionet por edhe për qytetarët të marrin vendime dhe politika, që do të kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve dhe me këtë përmirësimin e kualitetit të jetesës. Informatat jo të sakta dhe dezinformatat, janë aq shumë të pranishme, sa që ndonjëherë e varrosin edhe aftësinë tonë për identifikim të problemeve të vërteta dhe me prioritet.

Prandaj, është kryesore të gjithë, pa përjashtim të edukohemi si të mendojmë në mënyrë kritike dhe me atë ta zvogëlojmë ndikimin negativ që kanë lajmet e rreme.

Ky libër është një kontribut i vogël në këtë proces.

Bardhyl Jashari- Drejtor ekzekutiv i Fondacionit për internet dhe shoqëri – Metamorfozis

Dezinformatat dhe lajmet e rreme si terme janë shenjë e kohës sonë, por nuk paraqesin fenomen të ri. Përkundrazi, e nxjerrin në dritë problemin e vjetër të propagandës politike në një kohë kur gjeneratat e reja nuk e kanë kujtimin e epokës së ideologjive.

Mungesa e kujtimit na bën më cinikë në qëndrimin tonë ndaj betejave diskurseve politike dhe më pak të ndjeshëm ndaj rrezikut të propagandës në regjimet tradicionale të së vërtetës, të cilat paraqesin themele të demokracisë së vërtetë liberale. Përgjigja më e mirë ndaj dezinformatave është zhvillimi i shkathtësive rutinore për njohjen, dekonstrukcionin dhe refuzimin e tyre. Njohuritë elementare mediatike paraqesin një sërë të shkathtësive praktike që mund të ndihmojnë për t'u përballur më lehtë me numrin e shtuar të (dez)informatave në epokën e internetit.

Njohuritë elementare mediatike janë të domosdoshme dhe ato mësohen, por nuk mjaftojnë.

Mendimi kritik është një koncept më i gjerë sesa njohuritë elementare mediatike dhe i referohet qëndrimit themelor të individëve ndaj botës së jashtme, dinamikës së saj dhe raporteve të fuqisë.

Mendimi kritik është qëndrimi që e kanë individët ndaj burimeve të autoritetit gjatë jetës. Subjektet që kanë mendim kritik nuk krijohen me ndërhyrje ad-hoc, por përmes socializimit, në familje, në shkollë, në praktikatat e informimit, mësimit, përvetësimit të aftësive dhe inkurajimit të krijimtarisë tek të rinjtë. Mendimi kritik është i lidhur me vlerat themelore që i krijon dhe i promovon një shoqëri. Libri që e keni para vetes është një kontribut i vogël praktik dhe teorik, për atë se si vendimmarrësit duhet të mendojnë për rëndësinë e mbjelljes së vlerës së mendimit kritik në shoqëri. Pa mendim kritik nuk ka njohuri elementare mediatike.

Pa njohuri elementare mediatike, demokracia është nën presionin e propagandës.

Lufta kundër dezinformatave është betejë themelore politike për demokracinë.

Ljupço Petkovski - drejtor ekzekutiv i Eurothink - Qendra për Strategji Evropiane

Parathënie

Shkak për përgatitjen e këtij doracaku është projekti evropian me titull “KriThink: Mendim kritik për qytetarë me shkathtësi mediatike”. Aktivitetet e projektit parashohin trajnime të pjesëmarrësve që kanë fituar mjete për realizimin e projekteve të vogla, kështu që ky doracak duhet të shërbejë si **një literaturë fillestare dhe udhëzues praktik** në punën e tyre.

Për nevojat e doracakut u formua një ekip me përfaqësues nga sektori joqeveritar dhe ai shtetëror, nga shkencat shoqërore dhe natyrore (gazetaria, psikologjia, neuroshkencat sociale) dhe në përgjithësi individë me përvoja të ndryshme pune dhe pikëpamje të ndryshme. Ky doracak është rezultat i bashkimit kreativ dhe në formë kolazhi të perspektivave të ndryshme nga një ekip multidisiplinar i autorëve dhe koordinatorëve. Qëllimi përfundimtar është të fitohet një pasqyrë e shumanshme dhe e plotë mbi temën e vlerësimit kritik të informatave.

Arsyet e përgatitjen e këtij doracaku janë natyrisht më të përgjithshme dhe e prekin tërë popullatën e Maqedonisë së Veriut. Në fakt, analiza e paradokohshme e Indeksit të njohurive elementare mediatike në Evropë tregoi se në vitin 2018, vendet e Ballkanit janë më pak rezistuese ndaj fenomenit të post-vërtetës, ndërsa Maqedonia e Veriut është më në fund, gjegjësisht ajo është vendi me “ndjeshmërinë” më të lartë për lajme të rreme për shkak të shkallës më të ulët të arsimit cilësor dhe lirisë së mediave.

Prandaj, doracaku është krijuar me qëllim që të krijohet një **mjet themelor për informimin dhe edukimin** e qytetarëve të Maqedonisë, që do të kontribuonte në nxitjen e të menduarit kritik dhe krijimin e një kulture të dialogut konstruktiv. Literaturë që do të kontribuojë për dialog në të cilin ruhet e drejta për ta mbajtur mendimin e vet, me respektim dhe shqyrtim kritik të mendimeve të tjera.

Doracaku është i dedikuar për:

- Organizatat qytetare dhe institucionet qeveritare që me përpjekje të përbashkëta, duhet për çdo ditë të tregojnë për manipulimin mediatik me informatat dhe të kontribuojnë në zhvillimin e njohurive elementare mediatike midis qytetarëve të Maqedonisë.
- Çdo qytetar i Maqedonisë së Veriut duhet të luftojë për respektimin e standardeve profesionale në hapësirën mediatike dhe të përpiqet për mendim dhe shprehje të lirë.

Nga autorët,
Shkup, 2018

Hyrje

Njohuritë elementare mediatike sot janë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe përfaqësojnë një nga elementet thelbësore të shkrim–leximit qytetar. Media është një kanal i domosdoshëm për shkëmbimin e informacionit dhe një aktor integral në proceset politike bashkëkohore, komunikimet midis qytetarëve dhe autoriteteve publike. Në të njëjtën kohë ato ndikojnë në formimin e opinionit publik dhe ndërtimin e qëndrimeve ndaj vlerave shoqërore. Mediat janë të rëndësishme për realizimin e së drejtës për informim dhe realizimin e të drejtës për shprehje të lirë të çdo individi.

Njeriu bashkëkohor, për të qenë me të vërtetë i informuar, duhet të zotërojë aftësitë më të rëndësishme për të përdorur mediat:

- Të ketë qasje kritike për të lexuar për të kuptuar informacionin
- Të ketë aftësi teknike për të përdorur një medium të veçantë
- Të ketë njohuri që t'i qaset një mediumi të veçantë

Në mospërputhjen midis nevojës për të menduarit kritik dhe mungesës së njohurive elementare mediatike, krijimi dhe shpërndarja e njohurive elementare mediatike është një mjet kryesor për të luftuar ndikimin negativ të dezinformatave.

Ky doracak propozon aktivitete të ndryshme që do të thellojnë njohuritë e gazetarisë dhe aftësitë se si të përdorin në mënyrë kritike informacionin e marrë nga media të ndryshme. Ky fakt ka një rëndësi të veçantë sepse njeriu modern i sotëm përballet gjithnjë e më shumë me problemin e ri global të dezinformatave me të cilat përballet shoqëritë në përgjithësi. Adresimi i kësaj sfide globale, e cila përhapet në mënyrë të pashpjegueshme kudo, është shtypa kryesore për krijimin e këtij doracaku.

Në faqet e doracakut paraqiten përmbajtje nga një larmi fushash që lidhen me gazetarinë, mendimin kritik, mediat, njohuritë elementare mediatike dhe digjitale, lajmet e rreme.

Përmbajtja paraqitet përmes përshkrimeve, shembujve, aktiviteteve dhe ushtrimeve të ndryshme që mundësojnë që grupe të ndryshme të synuara t'i përdorin ato për t'u bërë qytetarë me njohuri mediatike.

Ky doracak promovon metodat e arsimit joformal që zakonisht kryhen jashtë procesit arsimor klasik (shkollat publike dhe universitetet), brenda kornizës së aktiviteteve të shoqërisë civile.

Ky doracak propozon aktivitete të ndryshme që mund të përshtaten si në shkollë ashtu edhe në mjedisin shkollor. Çdo aktivitet rendit temat, qëllimet, kohëzgjatjen dhe materialin e nevojshëm.

Thelbi i gazetarisë

Thelbi i gazetarisë është i shumëanshëm, por bërthama përbëhet nga dy gjëra: faktet dhe e vërteta. Prandaj, gazetaria është një disiplinë që interesohet (përmes fakteve) të përcjellë atë që me të vërtetë (e vërteta) ka ndodhur. Kjo është arsyeja pse disa teoricienë e quajnë këtë profesion "disiplinë të verifikimit", sepse gazetarët kërkojnë çdo ditë konfirmimin e së vërtetës. Gazetari mbledh, hulumton, analizon dhe paraqet informacion.

Gazetaria është profesion që i kundërshton me zë të lartë të gjitha padrejtësitë, diskriminimet, presionet dhe abuzimet në shoqëri, por edhe kundër propagandës dhe imponimit të mendimeve të njëanshme. Roli i saj është t'i bëjë problemet e tilla publike dhe të dukshme dhe të ofrojë zgjidhje për to. Prandaj, nga këtu del edhe rëndësia që gazetaria, çdo ditë është "gjaku i së vërtetës" në një shoqëri. Qëllimi më i rëndësishëm i gazetarëve është të informojnë qytetarët në mënyrë objektive dhe të paanshme. Ato krijojnë përmbajtje (tekste dhe stroje) përmes zhanreve të ndryshme gazetareske që ndikojnë në opinionin publik dhe kështu mbi ndryshimet në shoqëri.

Gazetari përdor burime informacioni për të vërtetuar se informacionin që e paraqet është i besueshëm. Një nga rregullat themelore në gazetari është se informacioni duhet të konfirmohet nga të paktën dy burime reciprokisht të pavarura dhe gazetari ka të drejtë të mos zbulojë emrin e burimit.

Sidoqoftë, gazetaria është një profesion që, për shkak të fuqisë që ka për të ndikuar në ndryshimet në shoqëri, është shënjestra e heshtjes. Bllokuesit kryesorë të së vërtetës janë zakonisht politikanët ose qendrat e fuqisë. Censurimi është i ndaluar dhe është përgjegjësi e gazetarit ta parandalojë atë. Për shkak të ndikimeve politike, autocensura gjithashtu rezulton në vuajtjen e "së vërtetës" dhe qytetarët nuk kanë asnjë mundësi të zbulojnë se çfarë ndodh.

Gazetaria është një profesion që nuk ka orare pune klasike, pasi informacioni vazhdimisht ndryshon dhe e vërteta duhet të arrijë më shpejt te qytetarët. Një shoqëri demokratike nuk mund të imagjinohet pa vëmendjen e kujdesshme të gazetarëve, të cilët ndjekin të gjitha zhvillimet shoqërore, madje edhe ato që publiku nuk mund t'i shohë drejtpërdrejt. Format e gazetarisë po ndryshojnë, veçanërisht me digjitalizimin, por është një kusht pa të cilin asnjë demokraci nuk mund të funksionojë.



Konceptet kyçe në lidhje me të kuptuarit e gazetarisë dhe diskursit publik janë:

OPINIONI PUBLIK

Opinioni publik përkufizohet si shprehja publike e një opinioni të veçantë të një shumice ose grupi qytetarësh për një problem apo një çështje të hapur. Qytetari i zakonshëm formon perceptimin e proceseve dhe situatave shoqërore bazuar në ndikimin e krijuesve të opinionit publik (të ashtuquajturit opinionmakers). Qytetarët, në fakt, kanë iluzionin se janë autorët e pikëpamjeve të tyre politike. Por, pak prej tyre kanë qasje në informacione përkatëse për të menduar në mënyrë të paanshme dhe të pavarur.

BURIMET E INFORMACIONIT

Burim informacioni në gazetari mund të jetë një dokument, një person, një institucion që ka, d.m.th. përmban disa informacione. Ndarja themelore e burimeve të informacionit është: burime primare dhe sekondare. Burimet primare kanë informacione të dorës së parë: dëshmitarë, pjesëmarrës të ngjarjeve, viktimat ... Burimet sekondare janë burime indirekte të informacionit kur informacionet gjenden në mënyrë indirekte: arkivat, ekspertët ... Në gazetari është e lejuar që të përdoren burime anonime.

INTERESI PUBLIK

Interes publik janë të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e përfaqësuesve të shtetit ndaj qytetarëve. Këto janë çështje ose politika që prekin jetën e shumicës së qytetarëve: të drejtat dhe liritë e njeriut, shpenzimi i parave të buxhetit, çështjet e sigurisë, standardet e jetesës ... Mediat janë rojet e interesit publik. Ata duhet të mbrojnë të drejtat themelore të njeriut për lirinë e fjalës dhe të shprehurit, për të informuar publikun për zhvillimet aktuale socio-politike...

CENSURIMI

Ndalimi i publikimit të informacionit me interes publik.

AUTOCENSURA

Gazetari me vetëdije vendos që të mos i kalojë ndonjë informacion publikut.

Format më të zakonshme të gazetarisë janë:

LAJMI

Lajmi është informacion me përmbajtje të re që ngjall interes të madh tek publiku. Që informacioni të jetë lajm, zakonisht duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme: të ketë përmbajtje të re, të rëndësishme, interesante, të pazakontë. Lajmi plotësisht përcillet kur ju jepet përgjigje pesë pyetjeve themelore që janë: "Kush?", "Çfarë?", "Kur?", "Ku?" dhe "Si?". Lajmet përfshijnë informacione për të gjitha aspektet e jetës së njerëzve: konflikte, katastrofa, ngjarje. Temat mund të jenë të ndryshme: shëndetësia, arsimi, ekonomia, drejtësia, politika sociale...

RAPORTI

Raporti është një formë e zgjeruar e lajmeve sepse përfshin një përshkrim më të dhe më të detajuar të ngjarjes ose dukurisë për të cilën informohet, së bashku me deklaratat nga pjesëmarrësit.

KOMENTI

Komenti është qëndrim i gazetarit ose redaksisë. Prandaj, komenti duhet të dallohet qartë nga lajmet ose raporti. Komenti është një zhanër standard i gazetarisë, por gazetari, përveç qëndrimit të tij personal, duhet të mbajë një distancë të caktuar nga ngjarjet dhe të mbështesë pikëpamjet e tij në argumente.

INTERVISTA

Një zhanër klasik gazetaresk, në të cilin përmbajtja ose lajmet transmetohen transmetohen si dialog. Intervistuesi, tema dhe pyetjet janë më të rëndësishmet në bërjen e intervistës.

ARTIKULLI

Artikulli është analizë e një ngjarje aktuale apo fenomeni në shoqëri me pasoja pasoja të caktuara, e cila nuk ka lidhje me informacionin e përditshëm.

KOLUMNA

Kolumna është një zhanër që përcjell një pikëpamje personale mbi temën e jetës shoqërore. Personi që shkruan kolumna quhet kolumnist dhe vetë kolumna nënkupton tekstin e shkruar që botohet grafikisht në një kolonë (lat. Columna).

REPORTAZHI

Zhanër specifik gazetaresk, i cili tregon për një ngjarje të veçantë apo vend duke e transferuar atmosferën. Ky zhanër lë vend për komentet e autorit dhe përshkrimet artistike në tregimet, d.m.th. transferimin atmosferës.

RECENSIONI

Teksti kritik që vlerëson një punë shkencore, artistike ose punë tjetër profesionale. Vjen nga fjala latine recensio, recensere që do të thotë "të shqyrtosh".

GAZETARIA HULUMTUESE

Gazetaria hulumtuese, në kontrast me gazetarinë e përditshme, shtjellon një temë të veçantë dhe zbulon fakte që nuk ishin të njohura për publikun. Nëse gazetari i përditshëm është një "oficer policie" që raporton atë që ka ndodhur, gazetari hulumtues shkon një hap më tej. Ai është "mjeku-ligjor" dhe që zbulon motivet dhe arsyet e asaj që ka ndodhur.

Të menduarit kritik

“Shkenca është një mënyrë për të shmangur vetë-mashtrimin. Është thelbësore që një person të mos mashtrorë veten edhe pse ai është personi më i lehtë për të mashtruar veten.”

- Riçard Fajnman, Fitues i Çmimit Nobël për Fizikë, 1965

Fjala "kritikë" vjen nga termi i lashtë grek "grykim" që do të thotë "aftësi për të dalluar, d.m.th. gjykuar". Efekti i grykimit të vlefshëm varet nga aftësia e të menduarit kritik. Të menduarit kritik mbështetet në rishqyrtimin logjik të deklaratave gjegjësisht pohimeve që lejojnë një perceptim objektiv të realitetit.

Të menduarit kritik është një proces i disiplinuar intelektualisht për të konceptuar në mënyrë aktive dhe të shkathtë, zbatimin, analizimin, sintetizimin dhe/ose vlerësimin e informacionit të marrë ose krijuar përmes vëzhgimit, përvojës, të menduarit të kujdesshëm, arsytimit ose komunikimit si një udhëzues për të besuar dhe vepruar. Në formën e tij primare është i bazuar në vlerat universale intelektuale që tejkalojnë pjesët e materies: qartësisë, saktësisë, precizitetit, qëndrueshmërisë, rëndësisë, prova të shëndoshë, arsye të mira, thellësisë, shpërndarjen dhe drejtësisë.

Të menduarit kritik mund të konsiderohet se përbëhet nga dy komponentë: 1) grup të informatave dhe besimesh që krijojnë dhe përpunojnë shkathtësi dhe 2) zakoni, i bazuar në angazhimin intelektual, të përdorimit të këtyre shkathtësive për të udhëhequr sjelljen. Kundër kësaj janë: 1) marrja dhe ruajtja e zhveshur e informacionit, pasi kërkon një mënyrë të veçantë të kërkimit dhe trajtimit të informacionit; 2) zotërimi i zhveshur i një grupi shkathtësish sepse kërkon përdorimin e tyre të vazhdueshëm dhe 3) përdorimi i zhveshur i këtyre shkathtësive ("si një ushtrim") pa pranuar rezultatet e tyre.

Të menduarit kritik ndryshon në bazë të motivimit që është pas tij. Kur rrethohet nga motive egoiste, shpesh manifestohet nga manipulimi i shkathtë i ideve sikur të ishte i disponueshëm për interesin personal të dikujt ose për interesin personal të ndonjë grupi. Si i tillë, sjell të meta intelektuale pa marrë parasysh sa i suksesshëm në mënyrë pragmatike është. Kur rrethohet nga paanshmëria dhe integriteti intelektual, zakonisht është i një rendi intelektual më të lartë, megjithëse i nënshtrohet nxitimit të "idealizmit" të atyre të mësuar me përdorimin e tij egoist.

Standardet e të menduarit kritik

Disa standarde intelektuale për të menduarit kritik janë të zbatueshme në mënyrë universale (në kontekste të ndryshme), dhe për këtë arsye janë të shënuara në Tabelën 1. Në mënyrë shtesë jepet një pasqyrë e çështjeve që do të ndihmojë për rishikim më të lehtë dhe analizë kritike të argumenteve për secilin standard veçmas.¹

STANDARDET E TË MENDUARIT KRITIK

QARTËSIA - Standard për korrektësi me shmangieje të argumenteve të dykuptimtë, të palogjikshëm ose konfuz.	A MUND TË PËRSHKRUHET ME LEHTËSI TEMA A MUND TEMA TË ILUSTROHET DHE MBËSHTETET ME SHEMBUJ
SAKTËSIA - Standard për respektim të argumenteve të cilët janë valid dhe të vërteta gjegjësisht i nënshtrohen kontrollit dhe verifikimit	A EKZISTON NJË MËNYRË PËR TË KONTROLLUAR DHE KONFIRMUAR ARGUMENTIN? SI MUND TË VËRTETOHET SAKTËSIA E ARGUMENTIT?
PRECIZITETI - Standardi për ezaurimin e një çështje me theksimin e detajeve, përmirësimin dhe specifikat	A ËSHTË I MUNDSHËM PËRSHKRIM MË SPECIFIK, MË KONKRET I TEMËS? A MUND TË JEPEN MË SHUMË DETAJE PËR TEMËN?
RËNDËSIA - Standard për rishikimin e aspekteve të cilat janë relevante për temën	NË ÇFARË MËNYRE ARGUMENTI I PARAQITUR KONTRIBUON PËR TEMËN? ARGUMENTI A I REFEROHET ÇËSHTJES KRYESORE TË TEMËS DHE A OFRON PËRGJIGJE TË RËNDËSISHME?
THELLËSIA - Standard i saktësisë së thellë (e kundërta e sipërfaqësore), e cila i merr parasysh të gjitha aspektet të cilat e përbëjnë kompleksitetin e temës	CILAT ASPEKTE E KOMPLIKOJNË TEMËN? CILAT ÇËSHTJE PARAQESIN VËSHTIRËSI PËR RISHIKIMIN DHE ZGJIDHJEN E PROBLEMIT?
GJERËSIA - Standard për gjithëpërfshirjen për rishikimin e më shumë qasjeve për të njëjtin problem	A EKZISTON NJË QASJE TJETËR PËR TEMËN? A MUND PROBLEMI TË KONSIDEROHET NGA NJË TJETËR KËND/PIKËPAMJE/PERSPEKTIVË?
LOGJIKSHMËRIA - Standardi i ndjekjes pasojës kauzale të argumenteve	A JANË TË LIDHURA NË MËNYRË LOGJIKE FILLIMI DHE FUNDI I TEMËS? A ËSHTË ARGUMENTI I MBËSHTETUR DHE A RRJEDH NGA ARGUMENTET E DORËZUARA?
RËNDËSIA - Standard për rishikimin aspekteve të cilët janë kyçe/qendrore/kryesore (gjegjësisht që nuk janë dytësore) për një temë	CILA ËSHTË TEMA KRYESORE? CILA ÇËSHTJE ËSHTË THELBËSORE PËR TEMËN? CILAT FAKTE JANË MË TË RËNDËSISHME PËR TEMËN?
DREJTËSIA - Standard i paanshmërisë dhe objektivitetit me përfshirjen e perspektivave të huaja, i zhveshur nga ndjenjat dhe interesat e veta	A KA INTERES PERSONAL PËR TEMËN? A KA QASJE TË PAANSHME NDAJ QËNDRIMEVE TË HUAJA PËR TEMËN?

Tabela 1 - Standardet universale intelektuale të të menduarit kritik dhe pyetjet që mund të ndihmojnë për përdorim më të lehtë në analizat e përditshme

Pse të menduarit kritik është i rëndësishëm për njohuritë elementare mediatike?

Çdo ditë shumë qendra të pushtetit (politik, biznesit, bashkësisë ekonomike) përpiqen të "shesin të vërtetën e tyre", dhe të menduarit kritik e bllokun mundësinë e manipulimit dhe joshjes, **gjegjësisht nga marrja e gjykimeve të gabuara.**

Është e nevojshme për të kuptuar lidhjet logjike midis ideve, për vlerësimin e argumenteve, për gjetjen e gabimeve në gjykim, për zgjidhjen sistematike të problemeve, për konfirmimin e rëndësisë së ideve, në mënyrë që të justifikohen idetë dhe besimet e veta.

Nocioni "të menduarit kritik" nuk duhet të barazohet me nocionin "kritikë negative". Kritika negative është një procedurë që përdoret shpesh në hapësirën mediatike, dhe përfshin **kundërshtim me qëllimin e vetëm për të provuar se diçka është e gabuar ose e rremë, pa dhënë arsye, gjegjësisht argumentet për të treguar se kritika është e justifikuar, d.m.th. e bazuar.**

Mekanizmat psikologjikë për të menduarit jokritik

Arsyet e të menduarit jokritik, të cilat janë për shkak të attributeve individuale, d.m.th. cilësitë e personalitetit (jo faktorët socialë), përcaktohen si mekanizma **psikologjikë për të menduarit jokritik.** Nga njëra anë, të menduarit jokritik është për shkak të gabimeve kognitive dhe nga ana tjetër, të predispozicioneve emocionale kur marrin informacion. Emocionet janë faktori motivues që e shtyn njeriun të veprojë dhe gjithashtu ndikojnë në mendimet që iu paraprijnë aktiviteteve. Mesazhet e krijuara mund të manipulojnë emocionet e audiencës duke shkaktuar histerinë masive të urrejtës, zemërim, panik ose frikë. Për një pasqyrë më të mirë, ato ndahen në dy grupe teorike, megjithëse në praktikë ato janë të ndërvarura dhe vazhdimisht plotësohen.

1. Të menduarit jo kritik për shkak të gabimeve kognitive:

- Gabimet në gjykim - **Gabimet logjike ose sofizmat janë gabime të gjykimit** (ang. Logical fallacies)² dhe **përfaqësojnë mospërputhje të paqëllimshme në gjykim** kur supozimet fillestare çojnë në një përfundim që nuk duhet të jetë i gabuar, por i pavlefshëm, gjegjësisht nuk del nga supozimet. Ato janë "hile" intelektuale me të cilat truri i njeriut aktivizon mekanizmat mbrojtëse me qëllim të ruajtjes së egos, identitetit dhe integritetit të vetë.

- Gabimet në argumentim - Për dallim nga gabimet logjike që përdoren rastësisht dhe pa dashje, **gabimet në argumentim** (ang. Argumentative errors) janë mospërputhje logjike që përdoren me qëllim sepse "fitorja" në një diskutim ose mosmarrëveshje është më e rëndësishme se "fitorja" e së vërtetës objektive.

- Njëanshmëritë kognitive- **Njëanshmëritë kognitive d.m.th. paragjykimet kognitive** (ang. "cognitive biases"³) janë devijime në proceset njohëse (të tilla si kujtesa, vëmendja, marrja e vendimeve) që manifestohen me gabime në arsyetimin, gjykimin, kujtesën dhe shpesh janë të pavetëdijshme dhe të pavullnetshme. Ata përfaqësojnë një "pikë të verbër" në procesin e të menduarit dhe një tendencë natyrore në çdo qenie njerëzore.

2. Të menduarit jo kritik për shkak të manipulimit të emocioneve:

- **Përdorimi i gjuhës me shtrembërime morale-emocionale**⁴ - është shprehje e gjykimit vlerësues moral duke shprehur emocione të forta (p.sh., dënim, përbuzje, neveri, krenari). Mesazhet me shtrembërime morale dhe emocionale zakonisht përdoren për të vlerësuar zhvillimet shoqërore dhe politike dhe zakonisht gjendet në rrjetet sociale.

- **Përdorimi i gjuhës së prekur** - zakonisht mendohet për **gjuhën e urrejtjes (hate speech)** me qëllim të poshtërimit, ngacmimit dhe sulmit të individëve/grupeve në bazë të gjinisë, moshës, pamjes (të tilla si lartësia, pesha dhe ngjyra e flokëve), përkatësisë etnike, fetare apo nacionale, orientimi seksual, klasa socio-ekonomike, profesioni dhe çdo tipar tjetër që është bazë për diskriminim.

3. Të menduarit jo kritik për shkak të manipulimit të emocioneve inkurajon:


- **Lirim nga përgjegjësia morale (moral disengagement)**⁵, e cila karakterizohet nga justifikim moral dhe etiketim eufemistik të veprimtarive imorale të një personi (p.sh. "luftëtarët e të drejtave" në vend të "terroristëve"), transferim.

- **Zemërim moral (moral outrage)**⁶, me poshtërimin publik dhe linçim të individëve/grupeve që janë larguar nga kodet morale të sjelljes, veçanërisht të pranishme në rrjetet sociale.

- **Paniku moral (moral panic)** është frikë e fortë nga kërcënimi që përhapet me shpejtësi tek komuniteti më i madh njerëzve. Rrjetet sociale veprojnë si dhoma jehonë, d.m.th. sisteme të mbyllura, ku për kohë të shkurtë të shpërndarjes së mesazheve në mes personave të të njëjtit mendim përforcohen dhe ndryshohen në madhësi.

Në Fotografinë 1 tregohet diagrami për secilin grup të gabimeve kognitive, ku janë treguar si grupe të veçanta duke pasur kufizime reciproke (të veçanta), dhe pjesët e përbashkëta (për gabime të përbashkëta kognitive).

Paragjykime kognitive „Cognitive biases“ (të paqëllimshme)



Fotografia 1. Diagrami me grupe të gabimeve kognitive (sipas grupeve), me kufizime reciproke (për gabime të veçanta) dhe prerje (për gabime të zakonshme kognitive).

Në vazhdim është dhënë zgjedhja e mospërputhjeve logjike dhe njëanshmërive kognitive më të përdorura gjatë manipulimit të informacionit:

Titulli	Original	Definicioni	Shembuj
Thirrje të autoriteteve	Ang. Appeal to authority Lat. Argumentum ad verecundiam	Prirje për t'i atribuar vërtetësisë një deklaratë nëse thuhet nga autoriteti.	Një mesazh propagandistik që interpretohet si i vërtetë vetëm sepse përcillet nga liderët politikë. Një person i veshur me pallto të bardhë pozon si mjek dhe reklamon pastën e dhëmbëve.
Thirrje në mundësisë	Ang. Appeal to probability	Prirje për të besuar se mundësia që diçka mund të ndodh është dëshmi se e njëjta do të ndodhë	Pohimi se me siguri do të ketë fluks të emigrantëve vetëm për shkak se ekziston mundësi (edhe shumë e vogël) që kjo të ndodh.
Keqkuptim për "Botë të drejtë"	Ang. Just world fallacy	Prirje për të besuar në vërtetësinë e ndonjë dëshmie, nëse shumica e mbështet	Nëse do të merrej e saktë deklarata se "2 + 2 = 5", vetëm për shkak se shumica e pohon këtë. Mesazhi reklamues "të gjithë hanë smokit tanë". Më shumë se 50% + 1 votuan për Partinë X, nëse nuk ju pëlqen ajo që ata bëjnë, nuk keni të drejtë të ankoheni deri në zgjedhjet e ardhshme.
Thirrja për mungesën e provave të kundërta	Ang. Appeal to ignorance Lat. Argumentum ad ignorantiam	Prirje për të besuar se një deklaratë është e vërtetë vetëm sepse i mungon prova që nuk është e vërtetë (si dhe anasjelltas)	Kur pretendohet se një i dyshuar ka vjedhur, sepse nuk ka prova se është i pafajshëm. (Mungesa e provave as nuk e konfirmon dhe as hedh poshtë pretendimin).
Thirrje në traditën	Ang. Appeal to tradition Lat. Argumentum ad antiquitatem	Prirje për të besuar në vërtetësinë e ndonjë dëshmie nëse e njëjta korrespondon me përvojën dhe traditën	Pretendimi se një sëmundje mund të shërohet me magji vetëm për shkak se kjo ka qenë një traditë që familja e ka pasur me gjenerata pas.
Dikotomi false	Ang. False dichotomy	Prirje për të paraqitur vetëm dy mundësi (zakonisht të kundërta) si zgjidhje të vetme, kur ekzistojnë më shumë mundësi.	Pretendimi se nëse dikush nuk është mbështetës i VMRO-DPMNE-së, patjetër duhet të jetë një mbështetës i LSDM-së.

Analogjia false	Ang. False analogy	Prirje për të bërë një analogji midis dy gjërave të palidhura, dhe pastaj analogjinë ta përdorim për të bërë një supozim.	Pretendimi se një punëtor në një korporatë të madhe duhet të eksploatohet, sepse ai është krahasuar me vidat e një makine të madhe e të përsosur.
Provat selektive	Ang. Cherry picking	Prirje për të treguar fakte që flasin për mbështetje të një pretendimi dhe në të njëjtën kohë injorim të fakteve që janë kundër të njëjtës.	Pretendimi se vaksinat shkaktojnë autizëm është bazuar në dëshmi të izoluar positive dhe injorim të dëshmive të shumta negative.
Arsyetimi rrethor	Ang. Circular argument Lat. Circulus in probando	Prirje për dëshmuar vërtetësinë e një pretendimi nën supozimin së është e vërtetë. Përdorimi i konkluzionit të synuar si supozim fillestar.	Pretendimi se çdo vrasës ka një çrregullim mendor sepse vetëm një person me çrregullim mendor do të mund të kryente vrasje.
Argument që lind nga përsëritja	Ang. Argument from repetition Lat. Ad infinitum	Prirje për të pretenduar në mënyrë të përsëritur se një deklaratë është e vërtetë edhe kur është vërtetuar si e pavërtetë.	"Një gënjeshtër mija herë e përsëritur bëhet e vërtetë"
Argument kundër njeriut	Ang. Personal attack Lat. Ad hominem	Prirje për sulm ndaj ndonjë pretendimi përmes sulmit të personit që e përfaqëson atë.	Pretendim se dikush nuk është thirrur të shprehë një qëndrim për një temë për të cilën ai është i kualifikuar, përmes tentimit për diskreditim të karakterit të tij në vend të njohurive të tij.
Thirrja e emocioneve	Ang. Appeal to emotion Lat. Argumentum ad passiones	Prirje për përdorim të fjalimit të bazuar në bindje në vend të fakteve, në mënyrë që të ngjallë emocione tek bashkëbiseduesi dhe të fitojë në diskutim.	Pretendimi që të gjithë qentë endacakë duhet të eutanizohen bazuar në përshkrimin e një skene traumatike ku një fëmijë sulmohet nga një qen endacak.
Prirje për të konfirmuar këndvështrimin e vet	Ang. Confirmation bias	Prirje për të kujtuar, favorizuar dhe gjurmuar informacione që konfirmojnë pikëpamjet ekzistuese.	Pretendimi se një shembull negativ për një përfaqësues të komunitetit pakicë është dëshmi që konfirmon besimet stereotipe për tërë komunitetin.

Prirja për anim të vëmendjes	Ang. Attention bias	Prirje për t'i kushtuar më shumë vëmendje informacioneve që sjellin më shumë vlera emocionale ose njohëse, ndërsa të injorohen të tjerat.	Kur në mënyrë aktive kërkohen prova për kërcënim të sulmit terrorist, për shkak të rritjes së frikës se e njëjta gjë mund të ndodhë.
Efekti i pritshmërisë së monitoruar	Ang. Expectation bias	Prirje për t'i atribuar një vlerë më të madhe të rezultateve që konfirmojnë pritjet nga ata që nuk i mbështesin.	Publikimi i një studimi me theksim të të dhënave që janë të dobi të pritjeve dhe shpërfillje e të dhënave që nuk flasin në dobi të tyre.
Efekti i paqartësisë	Ang. Ambiguity effect	Prirje për të shmangur zgjedhjet që përfshijnë pasiguri. Dhe, anasjelltas, favorizimi i mundësive me perspektiva të njohura për sukses përpara opsioneve me një mundësi të panjohur të suksesit.	Votim për një mandat të dytë për një lider politik, për shkak të pritjeve të njohura të praktikave të qeverisjes, si dhe për të shmangur surprizat në zgjedhjen e një kandidati.
“Pas kësaj do të thotë për këtë”	Lat. Post hoc ergo propter hoc	Prirje për të besuar se nëse një ngjarje i paraprinë një të dyte, ajo është shkak i shfaqjes së saj.	Pohimi se vakcina kundër shytave është shkak për shfaqjen e autizmit , sepse tek pacienti janë paraqitur simptoma të autizmit në periudhën pas vaksinimit.
Efekti i investimit të dështuar	Ang. Sunk Cost Fallacy	Prirje për vazhdimësi të mbështetjes gjegjësisht investim në një opsion të pafavorshëm për shkak të investimeve të kaluara në të.	Pretendimi se duhet të vazhdohet me sulme ushtarake mbi një bazë për arsye se shumë ushtarë kanë dhënë jetën e tyre për vendin, në atë luftë.
Neglizhimi i të dhënave themelore	Ang. Base rate error	Prirje për të vlerësuar në bazë të të dhënave specifike, duke mos i marrë parasysh të dhënat fillestare për një rastin e dhënë. .	Pohimi se një i sëmurë me HIV patjetër duhet të jetë homoseksual, sepse infeksioni është më i shpeshtë te ajo popullatë, duke mos u marrë parasysh se kjo pjesë e popullatës paraqet një përqindje të vogël të popullsisë së përgjithshme.

Mediat

Gazetari është kur publikohet diçka që dikush nuk dëshiron ta publikojë. Çdo gjë tjetër është marrëdhënie me publikun.

- XhroXH Oruell, gazetar dhe shkrimtar britanik

Ka shumë përkufizime se çfarë përfaqësojnë mediat (në varësi të aspektit), por sipas përkufizimit më të përgjithshëm, **mediumi është sistem komunikimi përmes kanaleve të të cilit transmetohet informacioni.**

Termi "media" në kuptim të përgjithshëm përfshin të gjitha llojet e mjeteve:

- transmetuesit si televizionet dhe radiot, mediat digjitale (internet portalet)
- media e shtypur (gazeta, revista)...
- pajisjet teknologjike në të cilat ruhen të dhëna të caktuara: DVD, CD, pajisje optike...
- telefonat, posta elektronike, SMS mesazhet, por edhe rrjetet sociale, blogjet, etj.


Në funksionimin e të gjitha llojeve të mediave rëndësi parësore kanë:

- **GJUHA E PËRDORUR NË MEDIA** – duhet të jetë e thjeshtë dhe e kuptueshme. Rekomandohen fjali të shkurtëra. Rregulli është: një fjali - një mendim. Në tekstin gazetaresk nuk ka vend për gjuhë administrative, zhargone, fraza klishe, fjalim figurativ...
- **NGJARJET E VLEFSHME MEDIATIKE** - çdo ngjarje që është e rëndësishme për publikun e gjerë. Ngjarja mediatike që është e vlefshme, është e lidhur direkt me interesin publik dhe është e lidhur me afatet kohore, konfliktin, afërsinë, polemikën, relevancën...
- **MEDIAT MASIVE (MAS-MEDIA)** - janë media që arrijnë një audiencë më të gjerë (për shembull: televizione që transmetojnë në të gjithë vendin ose gazeta që shiten në të gjithë vendin). Shprehja media masive bëhet veçanërisht e dukshme pas përhapjes së kulturës masive.
- **KORNIZA PROGRAMORE (AGENDA SETTING)** - Agenda setting (ose korniza programore) përkufizohet si ndikim ndaj mediave në zgjedhjen e përmbajtjes për krijimin e një agjende publike.
- **"EKONOMIA E VËMENDJES"(ATTENTION ECONOMY)** - Sipas këtij parimi, më e rëndësishmja është përmbajtja që do të tërheqë/ruajë vëmendjen më të madhe në rrjetet sociale. Kjo është për shkak të "bombardimit" të përditshëm me informacion kur vëmendja e përqëndruar bëhet një burim i vlefshëm. Prandaj, teknikat për të kontrolluar vëmendjen e shkaktuar nga një artikull i lajmeve bëhen të rëndësishme: numri i klikimeve, pëlqimeve, shpërndarjeve, ridërgimeve (përmes e-mail-it dhe mediave të tjera), numri i shikimeve të faqeve, etj.

Roli dhe funksionet e mediave në shoqëri

Përveç legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit, media përfaqëson pushtetin e katërt, joformal në një shoqëri. Roli i tyre është që të jenë qen roje (public watchdog) i interesit publik.

Ndarja tradicionale e mediave sipas qëllimit të tyre është të jetë informuese, edukative dhe argëtuese, kështu që ata kryejnë tre funksione themelore (Fotografia 2) :



Fotografia 2. Funksionet/ndarjet themelore (tradicionale) të mediave në shoqëri

Përveç funksioneve tradicionale të përmendura më lart, mediat gjithashtu kanë një funksion analitik dhe kritik, d.m.th. ato shërbejnë gjithashtu për të analizuar dhe komentuar mesazhet.

Roli kryesor i mediave në shoqëri është promovimi i pluralizmit të opinioneve dhe debateve publike, promovimi i vlerave demokratike dhe nxitja e pjesëmarrjes qytetare në jetën shoqërore, si dhe angazhimi i tyre kryesor të jetë liria e shprehjes.

Mediat në realitetin shoqëror

Nuk është lajm nëse një qen kafshon një njeri, lajmi është nëse një njeri kafshon një qen.

- Alfred Harmsfort, manjat-botues në Britaninë e Madhe, shekulli XIX

Mediat dhe politika

Politika në një vend varet shumë nga imazhi i realitetit politik të paraqitur nga media. Politikanët si qendra të pushtetit gjithmonë kanë kërkuar të kenë një kontroll më të madh mbi përmbajtjen dhe informacionin e dhënë nga media. Nga ana tjetër, media është në një garë të përditshme për informacione të reja dhe ekskluzive që do të mbajnë vëmendjen e publikut. Prandaj, shpesh ka një reagim mes këtyre aktorëve, në të cilin disa nga mediat përpiqen të zbulojnë lajmet direkt nga vetë zyrtarët publik. Në këtë mënyrë, media bëhet një ndërmjetës i mesazheve midis politikanëve dhe qytetarëve. **Ky ndërmjetësim gjithnjë e më shumë është në dy drejtime, kështu që përveç mesazheve nga politikanët në publik, media po bëhet një ndërmjetës që gjithashtu transmeton informacione nga publiku tek politikanët.**

Politika redaktuese është mënyra sesi media pranon, përzgjedh dhe prezanton ngjarjet politike.

Ndikimet në media mund të kryhen në mënyra të ndryshme. Mënyra më e zakonshme është përmes presionit të drejtpërdrejtë ndaj pronarëve të mediave dhe redaktuesve, si dhe me frikësimin ose pengimin e punës së gazetarëve. Duhet të theksohet se puna e mediave varet nga stabiliteti i tyre ekonomik, si dhe nga qëndrueshmëria e ndikimeve ekonomike. Përkatësisht, reklamuesit, ose sponsorët përmes hapësirës së tyre të reklamave, mund të shantazhojnë median dhe të vendosin në emër të tij nëse një artikull i veçantë lajmesh do të shfaqet në lajme.

Institucionet rregullatorë dhe vetë-rregullatorë të mediave

Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike (ASHAAM)⁷

Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike është organ rregullator autonom dhe i pavarur, jofitimprurës, me status të personit juridik, me autoritet publik për të rregulluar sferën e mediave në përputhje me Ligjin.

Një nga përgjegjësitë e ASHAAM-it është të promovojë dhe përmirësojë njohuritë elementare mediatike. Ky institucion ka zhvilluar gjithashtu një Program për promovimin e njohurive

elementare mediatike në Republikën e Maqedonisë së Veriut⁸. Qëllimi i programit është të rritet ndërgjegjësimi dhe të kuptuarit e njohurive elementare mediatike dhe të përmirësojë kushtet për pjesëmarrje qytetare dhe demokratike. Në vitin 2017, me iniciativën e Agjencisë, u krijua Rrjeti i Maqedonisë për njohuritë elementare mediatike.

Hulumtimi⁹ i Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike (ASHAAM) i realizuar në vitin 2016, për njohuritë elementare mediatike tek popullata e rritur, tregoi se 50,95% e të anketuarave kanë deklaruar se ata nuk i hedhin poshtë ose injorojnë të gjitha informacionet e publikuara, nëse vërejnë ndryshime thelbësore në mbulimin mediatik të të njëjtave ngjarje, 45.90% refuzojnë dhe 3.15% nuk kanë menduar.

Këshilli i Nderit¹⁰

Këshilli i Nderit është një organ vetë-rregullues i gazetarëve në Maqedoninë Veriore. Detyra kryesore e tij është të promovojë dhe përparojë parimet etike, kriteret dhe standardet e gazetarisë profesionale dhe të përgjegjshme, të përshkruara në Kodin e Gazetarëve të Maqedonisë “.

Gazetaria e mirë apo etike është në interes të publikut. Ajo ofron informacione që janë të sakta, të verifikuara, të ekuilibruara. Një gazetari e tillë është zëri i publikut, nuk është dhe nuk duhet të jetë partizan, duhet të bëjë dallimin midis fakteve, komenteve dhe opinioneve – pra praktikisht duhet të jetë e ndryshme nga propagandimi apo gazetaria tabloide – që plotësojnë çfarëdo qëllimi ose interesi tjetër dhe të cilat nuk e respektojnë plotësisht Kodin. Respektimi dhe promovimi i Kodit përmirëson besueshmërinë e mediave në publik dhe ato perceptohen jo vetëm si të lira, por edhe si përgjegjëse. Në të njëjtën kohë, respektimi i Kodit mbron vetë gazetarin – pasi ai ka të drejtë të refuzojë diçka që nuk është në përputhje me standardet profesionale dhe në të njëjtën kohë e përjashton atë nga gjykimi nga të tjerët, duke e lënë atë në gjykimin nga kolegët.

Çdo qytetar mund të paraqesë një ankesë në Këshillin e Nderit nëse ata dyshojnë se një gazetar shkel standardet dhe etikën profesionale në raportimin e tij. Këshilli i Nderit është i detyruar të rishikojë ankesën dhe të përcaktojë nëse gazetari ka raportuar në përputhje me Kodin e Gazetarëve..

Këshilli për etikë në media në Maqedoni¹¹

Këshilli është një organ për vetë-rregullimin e mediave dhe aktiviteti i tij është i bazuar kryesisht në përcaktimin e sanksioneve morale publike për mediat të cilat nuk i respektojnë standardet profesionale/etike, Kodin e gazetarëve dhe parimet e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve.

Misioni i Këshillit është që të angazhohet për mirëmbajtjen dhe promovimin e etikës dhe standardet profesionale në media për anëtarët e vetë dhe komunitetin e përgjithshëm të mediave në Maqedoninë e Veriut. Gjithashtu monitoron dhe përgjigjet fuqishëm për çdo ndërprerje të realitetit etik dhe profesional në përgjithësi, dhe vazhdimisht përpiket për lirinë e fjalës, luftën kundër censurës dhe vetë-censurimit, si dhe për heqjen e të gjitha pengesave që media dhe gazetarët të punojnë në përputhje me rregullat e profesionit dhe normat morale të gazetarisë.

Vizioni i KEMM është të përpiqet që mediat në Maqedoninë e Veriut të pranojnë parimet e gazetarisë profesionale dhe etike, duke ndjekur vazhdimisht lirinë e mendimit, fjalës dhe interesat e publikut. Në të njëjtën kohë, inkurajon publikun të mbështesë vetë-rregullimin dhe të kontribuojë që media të jetë e paanshme, e pavarur dhe e ekuilibruar në punën e vet.

Qëllimi i KEMM është të promovojë rregulla dhe norma etike në gazetari dhe të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për standardet profesionale dhe etike që media duhet ti respektojë.

Si mediat e prezantojnë dhe krijojnë realitetin

Informacioni për një ngjarje të veçantë duhet të patjetër të përmbajë një interpretim të caktuar të asaj ngjarje. Në nivel filozofik, kjo ndodh ashtu për faktin se **realiteti përcillet nga një subjekt** pas të cilit qëndrojnë përvoja të caktuara emocionale, edukative dhe shoqërore, kështu që subjektiviteti nuk mund të përjashtohet në procesin e transmetimit të realitetit.

Gjithçka që mediat paraqesin në publik në thelbin e saj është një konstruksion. Një numër i caktuar i informatave të zgjedhura japin një imazh të caktuar mediatik. Kjo varet nga shumë faktorë të tillë si :

- zgjedhja e fokusit dhe mënyra e raportimit,
- politika redaktuese e mediumit,
- forma e tekstit ose shtojca
- përmbajtja e tekstit ose shtojca,
- mënyra se si është krijuar
- gjuha e përdorur në informacion

Gazetari, gjegjësisht redaktori, zgjedh se cilat informacione do të vendosen, si do të formësohen, dhe kështu krijon një seri të vogël "ndërtimesh". Në media gazetari dhe redaktori respektojnë:

- **KORNIZËN PROGRAMORE/REDAKTUESE (AGENDA SETTING)** – përkufizohet si ndikim i mediave në përzgjedhjen e përmbajtjes për krijimin e një agjende publike.
- **“EKONOMIA E VËMENDJES” (ATTENTION ECONOMY)** – Sipas këtij parimi, më e rëndësishmja është përmbajtja që do të tërheqë/ruajë vëmendjen më të madhe të audiencës. Për më shumë sqarime mund të lexoni në faqe 21.

Gazetari dhe kryeredaktori i mediumit bëjnë përzgjedhjen e asaj që është një **ngjarje e denjë për media** që do të transmetohet në lajme. Redaktori vendos nëse artikulli, d.m.th. teksti do të publikohet në minutat e para të lajmit, pra në faqet e para të gazetës.

Realiteti në media mund të përfaqësohet në shumë mënyra, varësisht se për çfarë mediumi bëhet fjalë dhe cili është qëllimi që duhet të arrihet. Gazetari dhe redaktori janë krijuesit kryesorë të mënyrës së paraqitjes së informacionit, sepse ato bëjnë zgjedhjen e formës dhe përmbajtjes së lajmit.

Shembuj të titujve dhe lajmeve të konstruktura

Titulli	Shpjegimi
(FOTO) Aksidenti i tmerrshëm trafiku në Strumicë - Gjak nga të gjitha anët ¹²	Titulli pretendon se kishte "gjak nga të gjitha anët", por teksti thotë "nuk ka informacion për të plagosur apo të vrarë". Nëse nuk do të kishte lëndime ose vdekje, dhe në këtë rast nuk dihet nëse ka pasur, nuk mund të ketë gjak nga të gjitha anët. Informacioni i marrë nga Lidhja Automobilistike e Maqedonisë nuk përmend se trafiku ishte i rëndë dhe kishte gjak nga të gjitha anët. Këto të dhëna, media i shtoi me tendencë, për ta bërë titullin bombastik, sensacional dhe manipulues. Ndërtimi i titullit është krijuar për të tërhequr sa më shumë klikime që të jetë e mundur për lajmin, ndërsa manipulon me vetëdije që të joshë lexuesin për të klikuar në lajme dhe për të lexuar informacionet.
Foto: Katica Janeva me kallëzim penal kundër Latasit ¹³	Titull konfuz dhe i palogjikshëm. E pasaktë të pretendosh që PSP mund të paraqesë kallëzime penale. Akuzat penale dorëzohen tek prokurori publik, kurse prokurori publik nuk dorëzon akuza penale.
TRONDITJE, TRAUMA DHE KONTUZION NGA BRUKSELI PËR FAMILJEN GRUJOS DHE MIJALKOVIT: Në raportin e tij të fundit për Maqedoninë, KE do të kërkojë një departament të gjykatës speciale ¹⁴	Një ndërtim i gjatë i titullit, i ngarkuar me terma mjekësorë që janë të pakuptimta në këtë kontekst ("kontuzion"). Titulli flet për një raport të Komisionit Evropian kurse ilustron me ndërtesën e Parlamentit Evropian.
Vajzat maqedonase prostituohen në jahte malazeze ¹⁵	Problemi kryesor në këtë tekst është në titull, i cili bën një pretendim serioz se nuk ofrohet mbështetje. Kjo është etikisht e papranueshme sepse çon në manipulimin e lexuesve.
Ndërsa kryetari i Kumanovës mbanë syze qindra euro kjo familje 8 anëtarësh nuk ka sobë për ngrohje dhe jeton në varfëri ekstreme. ¹⁶	Mbi këto informacione është "shartuar" një titull spinues që synon të nxjerrë një politikan fajtor, i cili nuk ka asnjë lidhje me lajmin. Së pari sepse ndodh në një komunë krejtësisht tjetër - në Staro Nagoriçane, ku kryetari i komunës është një person tjetër dhe është i një opsioni tjetër politik, nëse kjo bëhet një moment i rëndësishëm. Me të vërtetë është e paqartë se si kryetari i Kumanovës mund të mbahet përgjegjës për diçka që po ndodh në një komunë tjetër?

<p>(ANALIZA): Para falimentimit 11 shtete në botë¹⁷</p>	<p>Teksti me 20 rreshta nuk mund të quhet "analizë" (kurse "analzë", siç thotë titulli gabimisht, në asnjë mënyrë). Kur kjo fjalë përdoret në një pozitë kaq mbizotëruese, lexuesit presin një lexim më të gjerë dhe analitik, ku ka një përpunim serioz dhe argumentues të llojeve të ndryshme të informacionit, opinioneve dhe qëndrimeve të ndryshme, si njohuri të reja.</p>
<p>Nesër në Maqedoni fillon lufta? Shikoni se çfarë ndodh në Butel¹⁸</p>	<p>Titulli është spekulativ, sensacional, i pasaktë dhe paralajmëron luftë! Ajo shkakton ankth tek qytetarët dhe mund të nxisë dhunë. Është njoftim dramatik i protestës së Butelit, e cila përfundoi pa u përshkallëzuar situata. Në përgjigje të protestave të shqiptarëve për vendosjen e një kryqi në Butel, me të vërtetë dolën edhe maqedonasit, por nuk pati tensionim të madh.</p>
<p>(VIDEO) KJO MEDOEMOS DUHET PARË, KËTË VETËM PSIKIATRI MUND TË DESHIFROJË: Gruevski vetë ishte i befasuar nga duartrokitjet, nga fytyra e tij lexohej - JU A JENI NORMAL QË ENDE MË DUARTROKISNI MUA, KUSH JENI JU TË ÇMENDUR?!?!¹⁹</p>	<p>Titulli është i përbërë nga disa fjali që janë të lidhura gabimisht me shenjat e pikësimit. Në titullin me ndërtim prej kilometra që përmban qëndrime personale, gjetje që nuk mbështeten nga fakte, por edhe fyese. Titulli është vetëm një sugjerim i asaj që duhet të presim në artikull.</p>
<p>Ankesa është refuzuar: Neymar dy vjet pas grilave!²⁰</p>	<p>Në titull thuhet qartë: "Neymar dy vjet pas grilave!" Dhe brenda tekstit lexohet: "Kjo do të thotë që edhe nëse shpallet fajtor, Neymar nuk do të shkojë në burg, pasi nuk ka qenë i dënuar më parë. Gjithashtu, do të thotë se Neymar nuk do të duhet të largohet nga Barcelona përfundimisht". Si mund të jetë e mundur këto dy pikëpamje të kundërta, të jenë në një artikull të lajmeve, është me të vërtetë e pakuptueshme.</p>

Gjithçka që është theksuar më lartë tregon se krijimi i lajmeve është një proces tek i cili ndikojnë shumë faktorë. Kuptimi i tyre është një parakusht kryesor për një qasje kritike për të dalluar informacionin e vërtetë nga dezinformatat, d.m.th. lajme të rreme.

Mediat në hapësirën digjitale

Media digjitale dhe ekonomia e vëmendjes në rrjetet sociale

Mediat më të përdorura në shoqërinë moderne në botë dhe në vendin tonë janë mediat digjitale. Këto medime praktikojnë politikë redaktuese që bayohet në parimin "**ekonomia e vëmendjes**" (**attention economy**), që është nxitësi kryesor për qarkullimin e informacionit nëpër rrjete sociale dhe internet në përgjithësi. Më shumë sqarime për këtë princip do të lexoni në faqe 21.

Njohuritë elementare mediatike

Çfarë janë njohuritë elementare mediatike?

Njohuritë elementare mediatike janë aftësi për perceptimin kritik dhe analitik të informacionit. Kjo do të thotë se qytetarët nuk janë marrës pasiv të informacionit nga media. Qytetarët me njohuri elementare mediatike nënkuptojnë opinion publik vigjilent dhe kritik, d.m.th. aktorë aktivë në proceset shoqërore. Term i shpeshtë gjithashtu është **njohuritë elementare kompjuterike, gjegjësisht, digjitale**, por i referohet aftësisë për të kuptuar dhe përpunuar teknikisht përmbajtjen elektronike dhe është vetëm një pjesë e njohurive elementare mediatike. Sipas kësaj, njohuritë elementare mediatike përfshijnë lexim të kujdesshëm, shikim, kuptim dhe analizë të përmbajtjes së informacionit që transmetohet.

Qytetarët marrin shumë informacione mbi tema të ndryshme të jetës shoqërore çdo ditë përmes mediave dhe mediave sociale. Midis tyre ka dezinformata, të cilat përmbajnë përmbajtje të pasaktë. Ndërsa rritet përhapja e dezinformatave dhe propagandës nëpër media, po kështu rritet edhe nevoja për njohuritë elementare mediatike.

Politika arsimore dhe njohuritë elementare mediatike

Arsimi është gjithnjë i ndërlidhur me njohuritë elementare mediatike, pasi është lidhja më e rëndësishme në procesin e krijimit të qytetarëve kritikë dhe aktivë. Qytetarët me arsim të lartë, të aftë të lexojnë me mirëkuptim, mbi të gjitha, do të jenë në gjendje të kuptojnë tekstin që e lexojnë. Duke kuptuar tekstin dhe mesazhin në të, ata do të jenë në gjendje të dallojnë përmbajtjet e spinuara dhe të manipuluarat të informatave nga informacionet e verifikuara. Në sistemin tonë arsimor, praktika e të kuptuarit të leximit është më pak e pranishme, kjo është për shkak të performancës së dobët të shumicës së testeve ndërkombëtare. Studimi ndërkombëtar PISA²¹ 2015 është shembulli i fundit për pasqyrën e tillë në sistemin tonë arsimor. Për dallim nga ne, në shtetet e zhvilluara aftësia për të lexuar me kuptim (shkrim-leximi gjuhësor) praktikohet nga moshë më e re dhe për këtë arsye në ato vende lehtësisht aplikohen njohuritë elementare mediatike.

Duke supozuar se shkrimi gjuhësor praktikohet në orët mësimore të gjuhës dhe letërsisë maqedonase, elementët e leximit mediatik janë ose mungojnë ose më shumë përfaqësohen si informacion në kurrikula në disa lëndë. Në tekstet shkollore të gjuhës dhe letërsisë maqedonase, edukimi qytetar, sociologji, informatikë, etikë ... përmendet njohuria elementare mediatike, por më shumë si

njohje e studentëve me llojet themelore të mediave dhe kuptimin e tyre. Disa nga këto lëndë janë të detyrueshme dhe disa janë zgjedhore. Kurrikulat duhet të përfshijnë përmbajtjen e njohurive elementare mediatike që i përgjigjet nevojës për të krijuar qytetari kritike dhe aktive në proceset demokratike.

“Mungesa e temave të mjaftueshme për njohuritë elementare mediatike pasqyron njohuritë e tyre për ndikimin e mesazheve mediatike, aftësitë e interpretimit, rolin dhe funksionet e mediave dhe, veçanërisht, krijimin e një qëndrimi kritik ndaj përmbajtjes së tyre.”²²




Në Strategjinë Gjithëpërfshirëse të Arsimit 2018-2025²³ dhe Planin Strategjik në Arsim 2017-2019²⁴ në Ministrinë e Arsimit fare nuk përmendet termi njohuri elementare mediatike.

Njohuritë elementare digjitale

Nocioni **njohuri digjitale** (ang. digital literacy) i referohet aftësisë së individit për të gjetur, vlerësuar, krijuar dhe shkëmbyer informacion të qartë (e-përmbajtje) nëpër platforma të ndryshme digjitale. Nuk ka një përcaktim zyrtar të njohurive elementare digjitale dhe më së shpeshti kuptohet si një kombinim i aftësive dhe njohurive që mundëson përdorimin e përditshëm të teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) të nevojshme për të përdorur dhe krijuar përmbajtje digjitale, të quajtura e-përmbajtje, në formën e tekstit, fotografive, dizajneve grafike, audio ose video incizimeve.

Përveç aftësive teknike që në fillim të shekullit të 21-të, përdorej termi **njohuri elementare kompjuterike**, forma moderne e njohurive elementare mediatike, përfshin edhe përvetësimin e njohurive që lidhen me fushat përkatëse të njohurive elementare mediatike dhe të menduarit kritik, si dhe të **drejtat digjitale**, pra të drejtat e njeriut në sferën digjitale. Ato janë baza për pjesëmarrje në jetën shoqërore përmes përdorimit të TIK-ve, veçanërisht duke mundësuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje ose plotësimin e nevojave individuale nën kompetencën shtetërore përmes përdorimit të shërbimeve të ndryshme elektronike, duke mundësuar **qytetarinë digjitale**.

Pra, në qoftë se për shembull marrim përgatitjen e përmbajtjes së tekstit të destinuar për botim në internet si pjesë e njohurive elementare digjitale nuk konsiderohet vetëm njohja e programeve për të shkruar tekstin dhe aftësinë për të përdorur një tastierë kompjuteri me një shpejtësi të caktuar, por edhe aftësinë për të hartuar tekst të lexueshëm sipas rregullave gramatikore dhe stilit të përshtatshëm për qëllimin. Në këtë kuptim, shkrim-leximi digjital nuk është zëvendësim i formave tradicionale të shkrim-leximit, por një përditësim që mundëson aplikimin e tyre në sferën digjitale. Një nga termat e përdorur së bashku me termin njohuri elementare digjitale është njohuria për përdorim në internet ose **ueb njohuritë** (ang. web literacy), të cilën Fondacioni Mozilla e përcakton si bazë për "Shkathtësitë e Shekullit XXI". Që përfshinë shkathtësitë për "lexim", "shkrim" dhe "pjesëmarrje" që kanë aspekte të zgjidhjes së problemeve, krijimtarisë, komunikimit dhe bashkëpunimit.

Të shkruarit	Të lexuarit	Pjesëmarrja
		
Dizajn, programim, përpilim, rishikim, remiksim	Vlerësim, sintetizim, navigim, kërkim	Rrjetëzim, mbrojtje, praktikat e hapura, kontribut, ndarje
Korniza për ueb njohuri elementare e "Mozilla" është shembull për qasje për promovim të njohurive themelore digjitale. Për secilën nga njësitë e ueb faqes learning.mozilla.org/en-US/web-literacy ka një mori të aktiviteteve për të mësuar, me ushtrime.		

Aftësia për të vlerësuar/evaluar mesazhet që njerëzit marrin përmes mediave të ndryshme digjitale, si pjesë e njohurive elementare digjitale, përfshin aftësinë për të ekzaminuar dhe kuptuar kuptimin e mesazheve, për të vlerësuar besueshmërinë e autorit dhe të dhënat e ekspozimit, si dhe cilësinë teknike të punës digjitale. Njohuritë elementare digjitale mundësojnë që qytetari të bëhet anëtar i përgjegjshëm shoqëror në komunitetin e tij të ngushtë dhe më të gjerë, i cili përhap vetëdijen për aspektet e ndryshme të tij dhe ndihmon bashkëqytetarët të gjejnë zgjidhje për dhe brenda familjeve, në punë ose në nivel lokal ose nacional.

Disa qytetarë dhe gazetarë që janë rritur pa shumë "ekspozim" ndaj teknologjive digjitale, siç janë gjeneratat e reja, tek ata mund të vërehet një nivel shqetësimi (të ashtuquajturën teknofobi) ose rezistencë kur iniciojnë çështje të lidhura me këto fusha, për shkak të paragjyimit se për atë kohë njohuri të ekspertëve që kanë vetëm profesionistë të kualifikuar të TI-së. Përkundrazi, ashtu si koncepti i lidhur ngushtë me njohuritë elementare mediatike nuk mund të monopolizohet vetëm nga komunikologët ose gazetarët, kështu njohuritë elementare digjitale (të cilat shpesh mbulohen nga konvergjenca mediatike) është gjithashtu një zonë me interes për institucionet arsimore, OSHC-të dhe mediat, pavarësisht nëse ata janë tashmë të specializuar në mbulimin e çështjeve të caktuara të informacionit.

Qëllimi i KEMM është avancimi i rregullave dhe normave etike në gazetari dhe ngritja e vetëdijes së publikut për standardet etike dhe profesionale që duhet t'i respektojnë mediat.

Të drejtat digjitale

Të drejtat digjitale janë një grup i të drejtave themelore të njeriut në mjedisin digjital dhe përfshijnë të drejtën e privatësisë, të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale, të drejtën e lirisë së shprehjes dhe fjalës, të drejtën e informacionit dhe të drejtat e autorit.

Këto të drejta po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme duke pasur parasysh përdorimin në rritje të teknologjive të informacionit në jetën e përditshme dhe profesionale, dhe numrin e qytetarëve që i përdorin ato. Ajo që është e veçantë për këto të drejta në shoqërinë e informacionit është se ato

shpesh praktikohen dhe ushtrohen së bashku, si një paketë. Kjo për shkak të konceptit unifikues të teknologjisë së informacionit digjital dhe mediave të reja.

Të drejtat digjitale mbulohen nga Rezoluta për Promovimin, Mbrojtjen dhe Zbatimin e të Drejtave të Njeriut në Internet, miratuar nga Këshilli i KB për të Drejtat e Njeriut më 5 korrik 2012²⁵

Në nivelin legjislativ, shumica e çështjeve të të drejtave digjitale në Maqedoni tashmë janë të përfshira në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, Ligjin për komunikime elektronike, Kodin Penal (në lidhje me gjuhën e urrejtjes) dhe Ligjin për përgjegjësinë civile për fyerje dhe shpifje. , si dhe ligjet që rregullojnë median, të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme.

Avokatët e të drejtave digjitale fillojnë nga premisa që të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve në botën digjitale duhet të kenë të njëjtën rëndësi si ato jashtë saj, kështu që ekspertët në këtë fushë përgjithësisht besojnë se nuk ka nevojë për miratimin e ligjeve të veçanta nga sfera digjitale.

Organizatrat që merren me të drejtat digjitale në Maqedoninë e Veriut kanë konsensus që fushat e mëposhtme janë përparësi:²⁷

- Përmirësimi dhe zbatimi i kornizës ligjore - harmonizimi me legjislacionin e BE-së, përfundimi i mosndëshkimit
- Promovimi i lirisë së fjalës kundrejt gjuhës së urrejtjes në internet
- Zhvillimi dhe promovimi i njohurive elementare digjitale
- Mbrojtja e privatësisë së komunikimeve në internet nga mbikëqyrja e pakontrolluar
- Zhvillimi, promovimi dhe respektimi i politikave për privatësi
- Zbatimi i kulturës së lirë dhe të drejtës së autorit
- Zhvillimi i e-qeverisjes: të dhëna të hapura dhe e-pjesëmarrje
- E-përfshirja: sigurimi i kushteve për përfshirjen e të gjithë qytetarëve në përfitimet nga shoqëria informatike është një detyrim i organeve shtetërore, tejkalimi i hendekut digjital, përkatësisht ndarja në mes të njerëzve që kanë dhe atyre që për arsye të ndryshme nuk kanë qasje në teknologjitë "e kudondodhura".
- Përmirësimi i të drejtave digjitale të fëmijëve



Njohuritë elementare digjitale si mjet për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në sferën digjitale vlen për të gjitha fushat e mësipërme, por veçohet për rëndësinë e saj të jashtëzakonshme. Megjithëse fëmijët që janë rritur me teknologji digjitale si kompjuter shtëpiak ose telefon celular mund të kenë një nivel të lartë njohurish dhe aftësish teknike, disa teoricienë përdorin për ta termin "indigjenë digjital". (ang. digital natives), ata shpesh nuk kanë njohuri për marrëdhëniet njerëzore, të fituara përmes edukimit dhe përvojës, si dhe aftësitë e të menduarit kritik që janë të nevojshme për të vlerësuar përmbajtjen për tu mbrojtur kundër manipulimit dhe të realizojnë të drejtat e tyre të njeriut siç është e drejta për sigurinë.

Ndarja e njohurive dhe shkathtësive, gjegjësisht edukimi i fëmijëve, drejtpërdrejt ose me anë të edukimit të dy grupeve të lidhura synuara: prindërve/kujdestarëve dhe mësuesve është shumë e rëndësishme për të promovuar të drejtat digjitale të fëmijëve.

Shembull tipik i aplikimit të kësaj qasje për ti adresuar të tre grupet e synuara është faqja e internetit www.bezbednonainternet.org.mk, e zhvilluar nga Fondacioni "Metamorfozis" në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe me rrjetin e organizatave të shoqërisë civile të specializuar në të drejtat e fëmijëve. Përveç udhëzimeve dhe lajmeve, kjo ueb faqe gjithashtu përmban përmbajtje multimediale, siç janë filmat edukativë në shumë gjuhë dhe lojërat në shumë gjuhë që fliten në Maqedoninë e Veriut, pasi qasja efektive për fëmijët në shumë raste kërkon që të përdoret gjuha e tyre amtare.

Burimi: „sigurt në internet“ ofron arkiv të mjeteve për përmirësimin e të drejtave digjitale të fëmijëve, në mes të cilave udhëzime dhe filmave.

Është e rëndësishme të bëhet një dallim shtesë me "fëmijët" që në legjislacionin e Maqedonisë identifikohen me të mitur, d.m.th persona nën 18 vjeç. Edhe pse ata të gjithë përdorin teknologji të reja në një farë mënyre dhe shpesh janë "indigenë" për sferën digjitale, nevojat e fëmijëve parashkollorë (deri në 6 vjet), fëmijët që ndjekin klasat e ulëta dhe më të larta të arsimit fillor (6-10 dhe 11-14 vjet), dhe në shkollat e mesme (mbi 15 vjet, të cilët gjithashtu përfshihen në kategorinë e rinisë ose rinjtë), në shumë aspekte ato ndryshojnë në mënyrë dramatike dhe kërkojnë qasje të ndryshme.

Si probleme kyçe në këtë fushë paraqiten dy grupe pyetjesh :

- Zhvillimi i formave të varësisë që lidhen me luajtjen e tepërt të video-lojërave (të ashtuquajturat gameing) ose përdorimin e pajisjeve të ndryshme, veçanërisht celularët për të kapur video përmbajtje.
- Rrezikimi i sigurisë për shkak të përdorimit të pahijshëm të rrjeteve sociale dhe mjeteve të tjera të komunikimit, siç janë sistemet e telefonisë dhe mesazheve.

Sidomos kritike janë fushat e mbrojtjes së të drejtës së privatisë dhe sigurisë në sferën digjitale, për shkak të ndjeshmërisë së fëmijëve dhe mundësive për ekspozimin e tyre ndaj ndikimeve të dëmshme dhe kontakteve, veçanërisht përmes përdorimit të papërshtatshëm të rrjeteve sociale, të cilat sipas definicionit janë të dizajnuara për përdoruesit më të rritur. Për shembull, "Fejsbuk" është e ndaluar për përdorim nga persona nën moshën 13 vjeç dhe është përgjegjësi e prindërve/kujdestarëve që fëmijët e tyre të mundësojnë të shkelin kushtet e përdorimit. Vendimi i një mësuesi për të përdorur një platformë si një mjet komunikimi mund të ndikojë gjithashtu nëse fëmijët do të bëhen përdorues të programeve kompjuterike dhe jashtë klasës, gjë që mund t'i ekspozojë tek përdoruesit e tjerë që mund të jenë edhe fëmijë edhe të rritur.

Mënyra më efektive për të përfshirë temat e kësaj fushe në kuadër të sistemit arsimor publik është për të kapërcyer perceptimin se bëhet fjalë për tema "teknologjike", sepse kështu kufizohen në mësim zgjedhor në kuadër të lëndës së informatikës. Plan programi duhet të përfshijë arsimim shtesë për pedagogë, psikologë dhe staf mësimor në të gjitha lëndët, veçanërisht ato që lidhen me zhvillimin e shkathtësive jetësore dhe njohurive të sistemit shoqëror.

Specifikat e terminologjisë të lidhura me njohuritë elementare digjitale

Çështja e zhvillimit të terminologjisë në lidhje me njohuritë elementare digjitale, rrjedh nga nevoja për të përmendur disa situata, funksione dhe sjellje plotësisht të reja që lindin nga përdorimi i teknologjive digjitale, të cilat më parë mund të kishin qenë dhe mund të mos ishin ekuivalente në botën analoge.

Zhargoni midis përdoruesve të teknologjisë së informacionit zakonisht bazohet në importin e drejtpërdrejtë të shprehjeve angleze, pasi ndërfaqja e përdoruesit është në përgjithësi në anglisht, dhe shumica e përmbajtjes fillimisht në dispozicion është në të njëjtën gjuhë. Shpesh edhe kur ekziston një ekuivalent lokal (maqedonas, shqiptar) i një termi të caktuar në anglisht, në praktikë preferohet termi "i importuar" dhe jo "origjinali". Nuk është vetëm një fenomen i ri i lidhur me internetin, ai është tashmë i pranishëm në informatikë. Për shembull, folësit e gjuhës maqedonase e përdorin më shpesh termin "kompjuter" sesa "smetaç". Kërkimi në Google për fjalën "kompjuter" jep 1.66 milion faqe, ndërsa për vetëm 16.6 mijë për "smetaç".

Përdorimi i platformave të caktuara të komunikimit shpesh çon në krijimin e komuniteteve (komunitetet onlajn), dhe madje edhe subkulturat, anëtarët e të cilëve adoptojnë përdorimin e një teknologjie të caktuar si pjesë të identitetit të tyre individual dhe grupor, zhvillojnë zakone të veçanta dhe zhargon ose theks të tyre. Për shembull, tek disa fëmijë mund të vërejmë se në vend të theksimit korrekt të "Jutjub-(YouTube), ata thonë "Jutub".

Në tridhjetë vitet e kaluara, "gjeneratat" individuale të përdoruesve (sipas llojit të teknologjisë, jo edhe sipas moshës) kanë zhvilluar elemente të përkatësisë grupore me një komunitet të veçantë, duke filluar me "kompjuterxhitë" (entuziastë kompjuterësh disa prej të cilëve më vonë bëhen profesionistë), përmes studimeve të duhura ose punës praktike me harduer dhe softuer), "modemxhi" (përdoruesit e formave të para të komunikimeve digjitale), i cili gjithashtu u bë një nga grupet e para të përdoruesve të hershëm të internetit në Maqedoninë Veriore në periudhën pas vitit 1995. Me shfaqjen e platformave në internet fituam "ircashët" (përdoruesit e sistemit InternetRelayChat – IRC, veçanërisht të aplikacionit mlRC), deri tek aktualët "tuitërxhinjtë", "jutjuberët" dhe shumë të tjerë.

Në mungesë të një sistemi të krijimit të konsensusit për adoptimin e termeve në këtë fushë në gjuhët lokale, termet shpesh pranohen spontanisht nga vetë përdoruesit, ndërsa gjuhëtarët, përkthyesit, lektorët gjuhësor dhe arsimtarët shpesh vihen në gjendje të gjejnë zgjidhje të thjeshta në frymën e gjuhës vendase ose duke iu përshtatur asaj që është bërë një normë de facto në praktikë. Për shembull, termi në anglisht "cyberbullying" (sajberbuling), i cili përfshin forma të ndryshme të dhunës verbale dhe forma të tjera të ngacmimit në botën digjitale, veçanërisht ato të synuara në mesin e fëmijëve, gjithashtu përdorin termin "dhuna kibernetike", nganjëherë "sajber frikësimi" por shpesh transliterimi i drejtpërdrejtë "cyberbullying".



Përveç kësaj, përpjekjet për të futur terme në përputhje me disa rregulla drejtshkrimi shpesh nuk arrijnë vetë përdoruesit, të cilët e konsiderojnë këtë si një formë të ndikimit të padëshirueshëm "jashtë" dhe ndërhyrjes në identitetin e tyre grupor. Ndjenjat e neverisë që mund të lindin në situata të tilla duhet të merren parasysh kur planifikoni dhe zbatoni aktivitete edukative.

Disa shembuj të mëposhtëm të termave që tashmë përdoren gjerësisht për të cilat nuk ka ndonjë përkthim zyrtar në gjuhën maqedonase tregojnë nevojën që arsimtari në këtë fushë të jetë i

vetëdijshëm për problemin e terminologjisë dhe nevojën për të rregulluar nivelin e gjuhës që ka qasje në një grup të caktuar që në një mënyrë të sigurojë mirëkuptim. Duke u nisur nga kjo bazë, atëherë mund të punojnë në modifikimin ose “përmirësimin” e terminologjisë.

„Trollim“ (ang. trolling) - tallje dhe nxitje e komunitetit online me komentet që janë kryesisht mesazhe ofenduese në mënyrë që qëllimisht të krijohet një mashtrim apo gënjeshtër ose të defokusohet debati.

„Trolle“ (ang. trolls) - kryesisht përdorues anonimë të mediave sociale (të tilla si facebook, twitter, youtube, instagram, snapchat, forume në internet dhe blogje), të cilët përdorin gjuhë fyese dhe madje edhe gjuhë urretjeje (shpesh të paraqitura nën maskën e cinizmit) me qëllim që të provokojnë zemërim, bujë, panik, frikë, trishtim, dëshpërim (d.m.th emocione negative) tek tjetri dhe për argëtim dhe kënaqësi e tyre (d.m.th emocionet pozitive).

Termi "troll" buron nga përrallat popullore nga Evropa veriore dhe i referohet llojit të përbindëshit që pret në pritë (nën urë, në shpellë), i cili nuk është shumë i zgjuar dhe mund të pushtohet. Në internet ka qenë gjithashtu i përhapur për shkak të ndikimit të trillimit epik, i cili përmend krijesa të tilla (veprat e Tolkien dhe lojërat që ata përdorën si frymëzim).

Shprehja "**bot**" përdoret gjithashtu si një term i lidhur, i cili është një formë e shkurtuar e "robotit", sepse përdoruesit e tillë sillen në mënyrë të përsëritshme dhe "mekanikisht", pa kreativitet dhe i ndjekin udhëzimet ose urdhrat e dikujt tjetër. Në komunikimin politik termat troll dhe bot partiak tashmë janë përdorur gjerësisht për profile anonime të krijuara si pjesë e një "ushtrie" propagande të partive politike.

Përdoruesit me ndikim ose "ndikuesit" (nga ang. influencers) - Kryesisht bëhet fjalë për njohës të mirë të internet-teknologjive të përparuara të platformave sociale, që përdorin aftësitë e tyre teknologjike dhe sociale për të rritur dukshmërinë e mesazheve që përhapin. Kohët e fundit, përmes platformave YouTube dhe Instagram, njerëzit e njohur të këtij lloji janë ngritur në nivelin e krijuesve të opinionit publik, veçanërisht për grupet specifike të synuara që adresohen drejtpërdrejt.

Internet "meme" ose "mim" (nga ang. meme, fjalë ekuivalente në informatikë për gjenet, ang. gene) - çdo informacion që evoluon në një fenomen shoqëror për arsye të transferimit dhe shpërndarjes së lehtë dhe të shpejtë nëpër platformat sociale. Zakonisht në procesin e transmetimit, informacioni ndryshohet nga përdorues të ndryshëm, gjë që kontribuon në një shikim edhe më të madh në hapësirën virtuale. Kur përdoruesit përmendin "memet", zakonisht bëhet fjalë për video, fotografi, hiperlidhje ose regjistrim humoristik, por përgjithësisht i referohet çdo shprehjeje, mendimi që përhapet përmes internetit në mendjet e përdoruesve në një mënyrë të ngjashme si gjenet që riprodhohen në organizmat e gjallë.

Bot social (ang. social bot) - softuer inteligjent që krijon ose lidh përmbajtje në mediat sociale me qëllim të: fabrikimit masiv të profileve fiktive të përdoruesve, rritjes së rreme të numrit të ndjekësve, grumbullimit në masë dhe publikimit të informacionit të rremë. Sistemet më të sofistikuar të këtij lloji kanë aftësinë të imitojnë sjelljen e përdoruesit njerëzor në nivelin e bisedës.

Liria e fjalës kundrejt gjuhës së urrejtjes

*Holokausti nuk filloi me vrasje.
Filloi me fjalë.
- Muzeu Memorial i Viktimave të Holokaustit,
SH.B.A.*

Liria e fjalës ose liria e shprehjes është një e drejtë themelore e njeriut që ka të bëjë me lirinë e individit për të shprehur mendimet ose idetë e tij ose të saj pa frikë nga hakmarrja, censura ose pasojat ligjore. Në kuptimin më të gjerë, **gjuha e urrejtjes** është keqpërdorimi i aftësisë për të komunikuar për qëllime kriminale dhe për këtë arsye është shpallur si vepër penale.

Edukatorët që transferojnë njohuri në këtë fushë duhet të mbajnë në mend se për shkak të mos njohjes së konceptit të të drejtave të njeriut, lirisë së shprehjes dhe bazave ligjore për mbrojtjen e tyre në aktivitetet hyrëse, ata duhet ti kushtojnë një pjesë të kohës së tyre për njohjen e publikut me këto terma dhe koncepte themelore.

Kur planifikoni aktivitete arsimore në këtë fushë, është jashtëzakonisht e rëndësishme të merret parasysh mosha e pjesëmarrësve në aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve ose lexuesve. Materiali duhet të rregullohet sipas moshës, në mënyrë që të kuptohet siç duhet, si dhe të shmangen keqkuptimet, veçanërisht në lidhje me zgjedhjen e shembujve të përditshëm.

Burimet: Publikimet në temë gjuha e urrejtjes të përshtatura për grupe të ndryshme të qëllimit



Udhëzuesi nr. 9 “E drejta për të folur nuk është e drejtë për gjuhë të urrejtjes” ka për qëllim audiencën më të re ku ka elemente grafike, gjuhë dhe shembuj të thjeshtësuar. Udhëzuesi nr.10 “Gjuha e urrejtjes në internet” ka për qëllim audiencën më të rritur dhe është më gjithëpërfshirëse, ku përfshihen shpjegime të hollësishme të koncepteve, duke përfshirë citate dhe shpjegime të hollësishme të shembujve.

Publikimet kanë qasje në format PDF në nemrazi.mk dhe crithink.mk



Përcaktimi i lirisë së shprehjes

Për të bërë dallimin midis kuptimit laik që shpesh përfaqësohet me gjuhën e urrejtjes, si deklarata që nxisin çdo ndjenjë negative dhe **rëndësinë juridike** si vepër penale, duhet të shpjegohet se të drejtat e njeriut janë thelbi i sistemit juridik modern, që është krijuar nga traktati i shumicës së njerëzimit pas Luftës së Dytë Botërore. Qëllimi i kësaj marrëveshje, të krijuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) është të mbrojë jetën dhe dinjitetin e të gjithë njerëzve në botë dhe të parandalojë tmerret e luftës.

Në të drejtën ndërkombëtare liria e shprehjes është futur në nenin 19 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948. Një tjetër dokument kryesor ndërkombëtar që është pjesë e sistemit tonë juridik është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilën Republika e Maqedonisë së Veriut e ka pranuar si anëtare e Këshillit të Evropës. Në nivelin kombëtar, kjo e drejtë mbrohet në nenin 16 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, i cili ka të bëjë me lirinë e shprehjes.

Neni 19 i Deklaratës Universale e të Drejtave të Njeriut thekson:

“Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti goftë, pa marrë parasysh kufijtë.”

Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut shteteve thekson:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me liçencë.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave të fshehta ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

Neni 16 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut thekson:

„ Garantohet liria e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe e shprehjes publike të mendimit. Garantohet liria e fjalës, paraqitjes publike, informimit publik dhe e themelimit të lirë të institucioneve për informim publik. Garantohet qasja e lirë tek informatat, liria e pranimit dhe e bartjes së informatave. Garantohet e drejta e përgjigjes në mjetet e informimit publik. Garantohet e drejta e korrigjimit në mjetet e informimit publik. Garantohet e drejta e mbrojtjes së burimit të informatës në mjetet e informimit publik. Censura është e ndaluar.“

Është e rëndësishme të kuptohet se liria e shprehjes nuk është një e drejtë absolute, por si të gjitha të drejtat e tjera të njeriut është e kufizuar nga mos-shkelja e të drejtave dhe dinjitetit të të tjerëve.

Gjuha e urrejtjes është keqpërdorimi i çdo forme të shprehjes, rezultati përfundimtar i së cilës është të inkurajojë dhe mundësojë kryerjen e krimeve të tjera, domethënë të krijojë një atmosferë për kryerjen e krimeve të tjera, duke përfshirë kryerjen e pushtimit, gjenocidit, spastrimin etnik ose persekutimin politik, ose vrasjen masive të njerëzve në bazë të përkatësisë së tyre grupore. Për pjesëmarrësit në trajnime ose lexuesit e materialeve arsimore që nuk janë jurist është e rëndësishme t'u shpjegohet se anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në Këshillin e Evropës do të thotë që organi i lartë gjyqësor në sistemin tonë juridik është Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) në Strasburg.



Shembull i gjuhës së urrejtjes – grafiti që bënë thirrje për gjenocid mbi baza etnike (në të zezë) dhe grafiti i dytë që shprehin rezistencë ndaj krimit (me të gjelbër).

Gjykatat e Republikës së Maqedonisë janë të detyruara me ligj që të zbatojnë praktikën e GJEDNJ-së në punën e tyre, kështu që aktgjykimet e mëparshme të kësaj gjykate duhet të përdoren si bazë për gjykim. Prandaj, në aktivitetet edukative në këtë fushë, përveç informacionit të çështjeve nga vendi (nëse ka), transmetohen gjithashtu informacione mbi gjykimet e GJEDNJ-së. Ato shërbejnë si një model për atë që do të ishte vendimi përfundimtar në një rast të veçantë, ndër të tjera në situata kur palët janë të pakënaqur me gjykimet e gjykatave në vendin e tyre.

Siç tregon prof. Mirjana Najçevska, eksperte për të drejtat e njeriut: “Kur GJEDNJ merr aktgjykim, ai është një aktgjykim kundër shtetit që nuk ka arritur të mbrojë të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”²⁸ Zbatimi i gjykimeve konsiston në pagimin e dëmeve të caktuara për ankuesin dhe zgjidhjen e çështjes në fjalë dhe zbatimin e ndryshimeve të tilla që parandalojnë raste identike ose të ngjashme në të ardhmen.

Anëtarët e Këshillit të Evropës, përfshirë Republikën e Maqedonisë së Veriut, për shkak të përvojës së tyre të drejtpërdrejtë me pasojat katastrofike të Luftës së Dytë Botërore dhe Holokaustit kanë marrë qëndrim se duhet të ekzistojnë kufizime ligjore për format e shprehjes që përmbajnë gjuhë të urrejtjes, si masë parandaluese kundër përsëritjes të fashizmit, domethënë nazizmit.

Për dallim nga Evropa, mjediset e tjera, të cilat nuk kanë pasur përvojë të drejtpërdrejtë me okupimin fashist në historinë e tyre, kanë një qëndrim të ndryshëm ndaj gjuhës së urrejtjes në sistemin e tyre juridik. Në Shtetet e Bashkuara, për shembull, gjykatat nuk e ndjekin atë si një krim më vete, por e konsiderojnë atë si një rrethanë rënduese në rastet e **krimeve të urrejtjes**, gjegjësisht duhet të vërtetohet se ka çuar në lloje të tjera të sjelljes kriminale, siç janë dhuna, vrasja, etj., të motivuar nga urrejtja ndaj grupit shoqëror të cilit i përket viktimat ose kriminelit ka menduar se i përket.

Definimi i gjuhës së urrejtjes

Në sistemin juridik evropian, ku bënë pjesë edhe vendi ynë, në përcaktimin se çfarë është dhe nuk është gjuha e urrejtjes përdoret **përkufizimi orientues**, sipas të cilës gjuha e urrejtjes konsiderohet:

„... të gjitha format e të shprehurit me të cilat përhapet, nxitet, promovohet ose arsyetohet urrejtja racore, ksenofobia, antisemitizmi ose forma të tjera të urrejtjes, të bazuara mbi mostolerancë, përfshirë edhe: mostolerancën e shprehur në formë të nacionalizmit dhe etnocentrizmit agresiv, diskriminimin dhe armiqësinë ndaj minoriteteve, migrantëve dhe personave me origjinë imigrante”. (Rekomandimi nr. R (97) 20 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi gjuhën e urrejtjes 1997).

Në përgjithësi, gjuha e urrejtjes shoqërohet me lloje të ndryshme të shprehjeve ekstremiste:

- gamë e gjerë e fjalimit ekstrem negativ
- forma ekstreme të urrejtjes dhe nxitjes së urrejtjes
- shprehje jashtëzakonisht lënduese dhe nxitëse
- forma ekstreme të paragjyqimeve dhe stereotipeve negative


Përkufizimi më i gjerë i gjuhës së urrejtjes përfshin të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në intolerancën mbi çdo bazë diskriminuese. Gjuha e urrejtjes është një abuzim i lirisë së shprehjes që përfshin shkeljen e të drejtave të të tjerëve.

Shtirirja e përkufizimit të gjuhës së urrejtjes nuk i referohet vetëm fjalës ose tekstit të shkruar, por mund të përfshijë edhe forma të ndryshme të shprehjes: përdorimi publik i simboleve të urrejtjes (p.sh., kryqin e thyer ose një kryq që digjet), postera, fletëpalosje, karikatura, mbishkrime, etj. muzikë, video, video lojëra ose përmbajtje të publikuara përmes mediave tradicionale ose në internet.


Gjuha e urrejtjes "online" ose "internet" ose "cyber-urrejtjes", nënkupton çdo përdorim të teknologjisë së komunikimeve elektronike për të përhapur përmbajtje anti-semite, raciste, ksenofobike, diskriminuese, ekstremiste apo përmbajtje terroriste.

Në internet gjithashtu ka një numër burimesh që mund të përdoren si burime për materiale edukative dhe shembuj në ligjërata dhe diskutime mbi gjuhën e urrejtjes.


Burime në internet: Ueb-faqe që e trajtojnë gjuhën e urrejtjes nga aspekte të ndryshme




nemrazi.mk
Arkivi gjithëpërfshirës i burimeve dhe lajmeve.



bezomrazno.mk
Video klipe edukative dhe debate televizive.



govornaomraza.mk
Paraqitja në hartë e rasteve të gjuhës së urrejtjes.



proverkanafakti.mk
Analizat dhe vlerësimet gazetareske të gjuhës së urrejtjes në media.

Shprehje të ngjashme të gjuhës së urrejtjes janë:

Mbjellja e frikës (ang. Fear mongering/scare mongering) - Mbjellja e frikës është një teknikë e përhapjes së spekulimeve ose thashethemeve të pabaza në lidhje me një rrezik të caktuar që po vjen. Qëllimi është të ngjallet frika e publikut për një çështje të veçantë.

Alarmizmi (ang. Alarmism) - Alarmizmi është paralajmërim i ekzagjeruar apo i tepërt për ndonjë kërcënim real apo të imagjinuar, të tilla si përhapja e vdekshmërisë nga sëmundjet infektive. Edhe pse rreziqet janë të vogla, mediat mund të bëjnë raportet sensacionale.

Paragjykimet dhe keqkuptimet rreth gjuhës së urrejtjes

Sfida kryesore me të cilën përballen edukatorët që punojnë për të kuptuar gjuhën e urrejtjes është njohja e dobët e kësaj teme tek qytetarët. Gjuha e urrejtjes është një term juridik, por përkufizimi i tij në terma juridikë nuk është ende pjesë e kulturës së përgjithshme, pasi nuk është përpunuar si pjesë e arsimit formal në dekada, kështu që shumica e popullsisë nuk ka qenë në gjendje ta përvetësojë atë.

Mbi të gjitha, gjuhën e urrejtjes në shumë raste, për shkak të përmbajtjes së saj emocionale, shumica e baraspeshojnë me cilën do formë të shprehjes, që mund të shkaktojë emocione negative siç janë urrejtja, frika, neveria, poshtërimi, fyerja, etj. Edukatori duhet të jetë i përgatitur të tregojë ndryshimet dhe ngjashmëritë midis këtyre kategorive. Gjuha e urrejtjes mund të përmbajë fyerje dhe shpifje, por jo me çdo kusht - mesazhet që thirrin në shkatërrimin ose përndjekjen e llojit të caktuar të njerëzve mund të shqiptohen me fjalë "të mira".

Është e rëndësishme për t'u shpjeguar ngjashmëritë dhe dallimet midis gjuhës së urrejtjes dhe :

- Shpifjes dhe fyerjes
- Diskriminimit
- Krimin nga urrejtja ... në kuptimin juridik .

Dhe, anasjelltas, një deklaratë mund të përmbajë si fyerje ashtu dhe shpifje dhe të nxisë urrejtje ndaj një individi, por nëse nuk prek grupin e saj shoqëror mund të mos përmbushë kriteret për krimin e gjuhës së urrejtjes. Në atë rast, personi në fjalë nuk mund të fillojë procedurë penale kundër të pandehurit, por mund të kërkojë drejtësi përmes një padie private në bazë të Aktit të Përgjegjësisë Civile për fyerje dhe shpifje.

“Gazetari nuk do të krijojë ose përpunojë me vetëdije informacione që rrezikojnë të drejtat ose liritë e njeriut, nuk do të flasë gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë dhe diskriminim në asnjë bazë (nacionale, fetare, racore, gjinore, sociale, gjuhësore, orientim seksual, politik...)”.
- Neni 10 i Kodit të gazetarëve të Maqedonisë

Shembuj të gjuhës së urrejtjes

Meqenëse gjuha e urrejtjes përdoret çdo ditë në Republikën e Maqedonisë dhe tema e gjuhës së urrejtjes shpesh është e lidhur me zhvillimet aktuale politike, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zgjedhjes së shembujve të përdorur në trajnime. Për shkak të polarizimit që mund të prekë pjesëmarrësit, është e rëndësishme që ligjëruesi të jetë i përgatitur t'i përgjigjet pyetjeve të menduara në lidhje me zgjedhjen e shembujve dhe të shpjegojë lidhjen e shembullit të dhënë me përmbushjen (ose mos përmbushjen) e kriterëve të gjuhës së urrejtjes në baza e përkufizimeve dhe zgjidhjeve ligjore.

Preferohet që shembujt të përfshijnë gamë të gjerë të palëve të interesuara dhe të jenë specifike. Sipas mundësisë shembujt mund të anonimohen, përveç nëse identitetet e pjesëmarrësve luajnë një rol në situatë - për shembull, që janë të lidhur direkt me statusin e tyre shoqëror, gjë që u jep atyre fuqi për të përhapur gjuhën e urrejtjes ose për të promovuar diskriminimin.

Duhet të kemi në mendje se përdorimi i shumë shembujve abstraktë nuk është i dëshirueshëm, në krahasim me diskutimin e jetës së përditshme, prodhimin e mediave dhe rrjetet sociale ku mund të gjenden praktikantët ose lexuesit direkt. Kjo do t'i ndihmojë ata të zhvillojnë aftësi njohëse si hap të parë në parandalimin e efekteve të dëmshme.


Sfida themelore në zgjedhjen e shembujve nga jeta e përditshme është mungesa e praktikës gjyqësore në Republikën e Maqedonisë Veriore. Meqenëse është një vepër penale, është më konstruktive të flitet në bazë të vendimeve të mara, kurse në mungesë të shembujve të tillë vendorë është e dobishme të diskutohen shembuj nga historia, në veçanti ligji ndërkombëtar ose shembuj bashkëkohorë nga vendet me sistem kompatibil juridik.

Shembuj historik: Faqet e para të botimeve, ku botuesit e të cilëve kanë qenë të dënuar për nxitje të gjenocidit nga ana e gjykatave ndërkombëtare.



Majtas: Gjuha e urrejtjes ndaj hebrenjve në "Jurishnik" nga Gjermania naziste. Botuesi i saj u dënua me vdekje në Gjyqin e Nurembergut për nxitje të gjenocidit..

Djathtas: Dehumanizëm dhe nxitje e gjenocidit përmes gazetës "Kangura" nga Ruanda. Popullin Tutsi e quan "buburrecat" dhe rekomandon hanxhar si një armë për një përballje me ta.



